



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS PARË  
TË JURIDIKSIONIT TE PËRGJITHSHËM  
LEZHË**

**Lezhë më 26.02.2025**

**NJOFTIM**

**Për vend të lirë pune në administratë në pozicionin “Kryetar i degës së buxhetit/financë”, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë**

Bazuar në nenin 42 gërma “a”, 57, të Ligjit Nr.97/2016 “Për organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Urdhërin e Prokurorit të Përgjithshëm, nr.17 datë 29.01.2025 “Për strukturën organike të Prokurorive të Shkallës Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, dhe Prokurorisë të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, ligjit 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin ndryshuar me ligjin 110, datë 15.10.2015, me qëllim plotësimin e vendit vakant në këtë pozicion shpall njoftimin;

**Kërkesat e përgjithshme për kandidatët**

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore, që nuk është shuar.

**Kërkesat e vecanta për kandidatët**

1. Të jete diplomuar ne shkenca ekonomike - dega Financë, niveli master shkencor ose të barasvlefshem me të.
2. Te kete përvoje profesionale jo më pak se 3 (tre) vjet ne fushën e kontabilitetit dhe /ose menaxhimit te buxhetit.
3. Të njohi dhe perdori shume mire programin alfa.
4. Prioritet është të ketë punuar në sistemin e drejtësisë.

**Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit**

Të gjithë kandidatët si më sipër duhet të dorëzojnë dokumentacionin si më poshtë:

- a. Jetëshkrimin;
- b. Kërkesë për aplikim
- c. Fotokopje të diplomës;
- d. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë përvojën në punë);
- e. Çdo dokumentacion që vërteton eksperiencën të tjera punësimi brenda ose jashtë vendit, të lëshuar nga punëdhënësi;
- f. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
- g. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- h. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

Kërkesa me dokumentacionin e lartpërmendur, duket të dorëzohet pranë zyrës së Protokollit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë në adresën : Lagjia “Besëlidhja”, Rruga “Luigj Gurakuqi”, Lezhë, çdo ditë pune, nga data 27.02.2025 – 12.03.2025.

Konkurrimi për vendin e punës së kryetarit të degës së buxhetit/financës, do të bazohet në:

1. Ligjin nr.97/2016, “Per organizimin e funksionimit të Prokurorisë së Përgjithshme;
2. Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,
3. Ligji nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar,
4. Ligjin nr.10296, date 08.07.2010 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin”
5. Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar,
6. Ligjin nr.152/2013 “Për Njësirin Civil”, i ndryshuar,
7. Ligjin nr.7961 datë.12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Konkurrimi do të zhvillohet në dy faza:

### **I. Faza e parë:**

- Verifikimi paraprak i kandidatëve për plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe atyre të veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurim

### **II. Faza e dytë përbëhet nga vlerësimi i kandidatëve që përfshin:**

- Vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore
- Vlerësimi me shkrim.
- Intervista e strukturuar me gojë.

### **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:**

- Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:
- Për vlerësimin e jetëshkrimit (cv) të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore, **15 pikë;**
- Për vlerësimin me shkrim, **60 pikë.**

- Për intervistën e strukturuar me gojë, **25 pikë**;

Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët do të bëhet nëpërmjet adresave të email-it, me mesazhe në numrin e celularit të kandidatit, në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme dhe ambjenteve të Prokurorisë së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Per cdo informacion më të hollësishëm gjithë të interesuarit te paraqiten në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS PARË  
TË JURIDIKSIONIT TE PËRGJITHSHËM LEZHË**